



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2233/ 10 prot.

Datë 09.10.2025

V E N D I M
Nr. 1424/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.10.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **1163/2025**, datë 01.09.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57649-08-11-2025, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 2,496,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “EGIAN MED” SHPK me NIPT L71715003C dhe adresë Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës me adresë “Lagja 4, Rruga Egnatia, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 01.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **1163/2025** ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57649-08-11-2025, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 2,496,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit dhe të publikojë modifikimet në SPE në përputhje me konstatimet e KSHA-së.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Egian Med” shpk.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 802/14 prot., datë 06.10.2025 me objekt “Njoftim mbi procedurën blerje pesticide me nr. Ref: REF-57649-08-11-2025”, protokolluar me tonën me nr. 2233/7 prot., datë 07.10.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës, njofton KPP se: “Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës më datë 11.08.2025 ka hedhur në SPE procedurën Blerje pesticide me nr. Ref-REF-57649-08-11-2025, ofertat për këtë procedurë do të hapeshin më datë 22.08.2025 ora 11:00. Më datë 20.08.2025 pranë autoritetit kontraktor dhe KPP është paraqitur një ankesë nga operatori ekonomik Egian Med. Të ndodhur në këto kushte ne si Ak bëmë pezullimin e procedurës, shqyrtimin e ankesës, paraqitjen e shqyrtimit të ankesës pranë KPP dhe pritëm derisa KPP të dilte me një vendim përfundimtar. Më datë 08.09.2025 pranë autoritetit kontraktor ka ardhur vendimi i KPP me nr. 1163/2025, datë 01.09.2025 i cili na kërkonte të bënim modifikimet e dokumentave të tenderit dhe të publikonim modifikimet në SPE. Por ne si autoritet kontraktor gabimisht e hoqëm nga pezullimi pa bërë modifikimet përkatëse në DST. Të ndodhur në këto kushte nuk mund të ngarkojmë dot shtojcën në SPE dhe të ndryshojmë datat për pranimin e ofertave.

Për këtë problematikë komunikuam me APP në rrugë elektronike dhe përgjigja që na u komunikua se teknikisht rikthimi në pezullimin e procedurës për të ngarkuar shtojcën me ndryshimet e bëra është e pamundur. APP na sugjeroj të komunikojmë me KPP, për të na lejuar anulimin e kësaj procedure në pamundësi në pamundësi për të zbatuar vendimin e KPP-së me nr. 1163/2025, datë 01.09.2025 dhe rihedhjen e procedurës rishtas me ndryshimet e bëra sipas vendimit të KPP-së...”

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton

II.1. Në datën 01.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **1163/2025** ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Egian Med” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57649-08-11-2025, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 2,496,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit dhe të publikojë modifikimet në SPE në përputhje me konstatimet e KSHA-së.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Egian Med” shpk.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.2. Me shkresën nr. 802/14 prot., datë 06.10.2025 me objekt “Njoftim mbi procedurën blerje pesticide me nr. Ref: REF-57649-08-11-2025”, protokolluar me tonën me nr. 2233/7 prot., datë 07.10.2025, autoriteti kontraktor Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës, njofton KPP se: “Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës më datë 11.08.2025 ka hedhur në SPE procedurën Blerje pesticide me nr. Ref-REF-57649-08-11-2025, ofertat për këtë procedurë do të hapeshin më datë 22.08.2025 ora 11:00. Më datë 20.08.2025 pranë autoritetit kontraktor dhe KPP është paraqitur një ankesë nga operatori ekonomik Egian Med. Të ndodhur në këto kushte ne si Ak bëmë pezullimin e procedurës, shqyrtimin e ankesës, paraqitjen e shqyrtimit të ankesës pranë KPP dhe pritëm derisa KPP të dilte me një vendim përfundimtar. Më datë 08.09.2025 pranë autoritetit kontraktor ka ardhur vendimi i KPP me nr. 1163/2025, datë 01.09.2025 i cili na kërkonte të bënim modifikimet e dokumentave të tenderit dhe të publikonim modifikimet në SPE. Por ne si autoritet kontraktor gabimisht e hoqëm nga pezullimi pa bërë modifikimet përkatëse në DST. Të ndodhur në këto kushte nuk mund të ngarkojmë dot shtojcën në SPE dhe të ndryshojmë datat për pranimin e ofertave.

Për këtë problematikë komunikuam me APP në rrugë elektronike dhe përgjigja që na u komunikua se teknikisht rikthimi në pezullimin e procedurës për të ngarkuar shtojcën me ndryshimet e bëra është e pamundur. APP na sugjeroj të komunikojmë me KPP, për të na lejuar anullimin e kësaj procedure në pamundësi në pamundësi për të zbatuar vendimin e KPP-së me nr. 1163/2025, datë 01.09.2025 dhe rihedhjen e procedurës rishtas me ndryshimet e bëra sipas vendimit të KPP-së...”

II.3. Në rastin konkret, referuar informacionit më sipër të autoritetit kontraktor ky i fundit ka hequr gabimisht procedurën nga pezullimi pa kryer modifikimet në dokumentet e tenderit në zbatim të vendimit të KPP-së nr. 1163/2025, datë 01.09.2025 dhe pa pritur një vendimi nga KPP për të lejuar vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit. Përmes këtij veprimi, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot. Datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin

e vendimeve te Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedures së prokurimit” në të cilin parashikohet se: “2. Me marrjen dijeni të vendimit të KPP mbi themelin e çeshtjes, autoriteti kontraktor, duhet të hartojë shtojcën përkatëse, të cilën duhet ta publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (në vijim "SPE"). Autoriteti Kontraktor duhet të reflektojë në shtojcat e hartuara në zbatim të vendimit të dhënë, të gjitha ndryshimet që përmban vendimi i KPP, dhe të vërë në dijeni KPP mbi zbatimin e vendimit.

3. KPP, me marrjen e informacionit të autoritetit kontraktor dhe në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, do të vijojë me nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm për heqjen ose jo të pezullimit të procedures së prokurimit.

Kujdes!AK nuk duhet ta nxjerrë një procedure nga statusi i pezulluar dhe nuk duhet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës, pa nxjerrë KPP një vendim për heqjen e pezullimit.

4. Në rast se KPP konstaton se:

a) autoritetet kontraktore kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP me vendim të arsyetuar vendos heqjen e pezullimit. Pasi vihet në dijeni të këtij vendimi, autoriteti kontraktor duhet të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me me nenin 42, pika 2/1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe më pas të nxjerrë procedurën nga pezullimi.

b) autoritetet kontraktor nuk kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP vendos për lënien në fuqi të masës së pezullimit. Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë menjëherë vendimin, si dhe të publikojë shtojcën mbi ndryshimin e dokumentave të tenderit në SPE dhe të njoftojë KPP.

Në çdo rast, me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomik bazuar në parimin e transparencës, si dhe duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin e heqjes së pezullimit, autoritetet kontraktore rekomandohen të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 21, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, vetëm pas marrjes dijeni të vendimit për heqjen e pezullimit nga ana e KPP-së.”

Gjithashtu në nenin 100 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se :

“1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

Sa më sipër duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin që KPP lejon autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk duhet të vazhdonte me tej procedurën në rastin konkret me heqjen nga pezullimi në sistem pa një vendim të KPP-së.

II.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke e hequr nga pezullimi atë pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj.

II.5. Në këtë kuadër duke analizuar të gjitha faktet dhe rrethanat, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë konstatimet e vendimit të K.P.P nr.1163/2025, datë 01.09.2025 nuk mund të bëhen më pjesë e dokumentave të tenderit pasi autoriteti kontraktor ka hequr procedurën nga pezullimi pa një vendim të KPP-së dhe në këto kushte nuk mund të ngarkojë më shtojcën në SPE, e vetmja mënyrë për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë ankimues nga njëra anë dhe interesin publik nga ana tjetër, është lejimi i autoritetit kontraktor për të anuluar procedurën e prokurimit dhe ripublikimin e procedurës në përputhje me konstatimet e vendimeve të K.P.P. Nr. 1163/2025, datë 01.09.2025.

Sa më sipër, bazuar në shkeljet procedurale të kryera, **Komisioni i Prokurimit Publik i tërheq vëmendje autoritetit kontraktor që në asnjë rast nuk duhet ta nxjerrë një procedure nga statusi i pezulluar dhe nuk duhet të vijojë me hapat e tjerë të saj, pa nxjerrë Komisioni i Prokurimit Publik një vendim për lejimin e vijimit me hapat e mëtejshëm të procedurës.**

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57649-08-11-2025, me objekt: “Blerje Pesticide”, me fond limit 2,496,000.00 Lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 22-08-2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja Shërbimeve Komunale Durrës
2. Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit si dhe të dërgojë në KPP dokumentet e reja të procedurës që do të rihedhë në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin Nr. 1163/2025, datë 01.09.2025.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

